



**Datë:** 11.08.2025

**Numër Protokoli:** 5452/2025

**A.nr. 1256/2025**

**Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave**, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1256/2025, të datës 01.07.2025, të parashtruar nga ankuesi A.T, nga Suhareka, kundër organit të punësimit/Komunës së Suharekës, në çështjen juridike “*pezullim parandalues*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafi, 1.1 dhe nenin 18, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.08.2025, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Refuzohet si e pabazuar** ankesa me numër A.nr.1256/2025 e datës 01.07.2025 e parashtruar nga ankuesi A.T.

**II. Mbetet në fuqi** Vendimi 01-Nr-016-32914 i datës 09.06.2025, i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Suharekës.

## A r s y e t i m

Nëpunësi civil, A.T (*tani e tutje ankuesi*), i cili sipas shkresave të lëndës është i punësuar në Komunën e Suharekës, me datë 26.06.2025 përmes poste ka parashtruar ankesë e cila me datë 01.07.2024 është pranuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe protokolluar me numër:4438/2025 nën shenjë A.nr.1256/2025, kundër Vendimit me shifër 01-Nr-016-32914 i datës 09.06.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Suharekës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Komuna e Suharekës, ndërsa Këshilli më datë 08.03.2025 nga kjo e fundit ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova:** Ankesën me Nr.prot:4438/2025 të datës 01.07.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 09.06.2025 i Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Komunës së Suharekës; Procesverbal i datës 28.05.2025 PKR.nr.31/25; Zarf postar me shifër R8877324; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 04.07.2025; Përgjigje në kërkesë e datës 08.08.2025; Akt Emërimit e ankuesit i datës 28.12.2011; Aktakuzën PP/I nr.36/23 nga Prokuroria Themelore në Prizren e datës 30.04.2025.

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit A.T është e **pabazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesi sipas Akt Emërimit të datës 28.11.2011 është i punësuar në pozitën e punës “Zyrtar i Lartë Financiar-Zotues”, në kuadër të Komunës së Suharekës, kurse Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me datë 09.06.2025 ka nxjerrë Vendimin 01-Nr-016-32914 përmes të cilit ankuesi është pezulluar nga marrëdhënia e punës me 50% të pagës deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Gjykata, me arsyetimin se ndaj të njëjtit është iniciuar procedurë penale, respektivisht është ngritur aktakuzë.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill kundër aktit kontestuar, pretendon se organi i punësimit ka zbatuar gabimisht ligjin dhe ka vepruar në mënyrë të parakohshme pasi që i njëjti nuk e ka ende statusin e të akuzuarit pasi që gjykata nuk e ka konfirmuar ende aktakuzën.

Kolegji i Këshillit lidhur me çështjen e pezullimit sikurse në rastin e kontestuar të ankuesit, analizoi legjislacionin në fuqi, respektivisht dispozitat e nenit 69 paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 dhe nenit 71 paragrafi të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *“Nëpunësja/i civil pezullohet sipas detyrës zyrtare, në rastet si në vijim: ndaj nëpunësës/it civil është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të saj/tij; Nëpunësja/i civil gjatë periudhës së pezullimit nuk përfiton pagë, me përjashtim në rastin e përcaktuar në paragrafin 1., nën-paragrafët 1.4., 1.5., 1.6. dhe 1.7. të nenit 69 të këtij ligji, nëpunësja/i civile përfiton pesëdhjetë për qind (50 %) të pagës së plotë, duke përjashtuar çdo lloj shtesë në pagë, deri në fund të periudhës së pezullimit.”*, dhe gjeti se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore nxjerrjen e aktit të kontestuar e ka arsyetuar me faktin se ndaj ankuesit është duke u zhvilluar procedurë penale lidhur me dyshimin për kryerjen e veprës penale *“keqe përdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”*, konstatim ky i përcaktuar sipas Aktakuzës PP/I nr.36/23 me të cilën konfirmohet se ndaj ankuesit Prokuroria Themelore në Prizren me datë 30.04.2025 ka filluar hetimet zyrtare, gjegjësisht ka ngritur aktakuzë.

Lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit, theksojmë faktin i njëjti duhet kete parasysht faktin se sipas dispozitave të ligjit material, gjegjësisht neni 1 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ka përcaktuar se: *”Ky ligj ka për qëllim rregullimin e marrëdhënies së punës së zyrtares/it publik në institucionet e Republikës së Kosovës, përkatësisht përcaktimin e rregullave dhe parimeve që rregullojnë pranimin, klasifikimin e pozitive, ndryshimin, përfundimin e marrëdhënies së punës, të drejtat dhe detyrimet në raport me*

*marrëdhënien e punës, si dhe çështjet tjera që kanë të bëjnë me marrëdhënien e punës së zyrtares/it publik në institucionet e Republikës së Kosovës”, ashtu që dispozita e lartcekur ka përcaktuar qartë se cila është baza ligjore që rregullon çështjen e natyrës së ngjashme që burojnë nga marrëdhënia e punës të zyrtarit publik në institucionet e Republikës, nga rrjedh se pretendimi ankimor i palës ankuese nuk është i bazuar, pasi që ligji material e ka përcaktuar qartë se nëpunësi civil pezullohet sipas detyrës zyrtare, në rastet kur ndaj tij është iniciuar procedurë penale për kryerje të veprës penale gjatë ushtrimit të funksioneve të saj, pasi që Aktakuza me shifër PP/I nr.36/23 e datës 30.04.2025 e Prokurorisë Themelore në Prizren është argument i mjaftueshëm përmes të cilit konfirmohet fakti se ndaj ankuesit është iniciuar procedurë penale për kryerjen e veprës penale, prandaj Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 09.06.2025 ka vepruar drejtë dhe ka zbatuar në mënyrën e duhur ligjin material sikurse përcaktohet me nenin 69 paragrafi 2 i Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarë Publik: “Përveç kur përcaktohet ndryshe me këtë ligj, konstatimi i shkakut të pezullimit bëhet nga: 2.1. NjMBNj e institucionit, ku nëpunësja/i ushtron detyrën”.*

Kolegji i Këshillit thekson faktin se pezullim i marrëdhënies së punës sipas detyrës zyrtare sikurse në rastin konkret nuk krijon pasiguri juridike për palën ankuese, ngase në kuptim të nenit 68 paragrafi 2 dhe 3 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: “Gjatë periudhës së pezullimit, marrëdhënia e shërbimit civil nuk mund të përfundojë dhe nuk mund të ndryshojë, përveçse me kërkesën e nëpunëses/it të pezulluar ose kur parashikohet shprehimisht me këtë ligj. 3. Nëpunëses/it civil i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga puna dhe marrëdhënia e punës gjatë periudhës së pezullimit, përveç të drejtës për tu kthyer në vendin e punës, sipas këtij ligji”, pezullimi nuk nënkupton përfundim të marrëdhënies së punës ngase ankuesit i është njohur e drejta për kthim në vendin e punës pas pushimit të arsyeve për të cilat është pezulluar sipas kushteve dhe rrethanave të përcaktuara të këtij ligji.

Theksuar si me lart, Kolegji i Këshillit duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda, A.nr.1256/2025, datë 11/08/2025**

**Flakron GASHI**

\_\_\_\_\_  
**Procesmbajtës**

**Arben MEHMETI**

\_\_\_\_\_  
**Kryetar i Kolegjit**

**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit A.T;
- Komunës së Suharekës (Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore); si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.